



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 10
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1
Prishtinë, më 2 shkurt 2018, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Flora Brovina, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Time Kadrijaj, Faton Topalli dhe Haxhi Avdyli.

Munguan: Miljana Nikoliq , Bekim Haxhiu dhe Naser Rugova.

Të ftuar : Barbara Gysi, deputete nga Parlamenti i Zvicrës, Skënder Reçica - ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ruzhdi Ibrahimimi dhe Osman Osmani, sindikata "UNIA", Zvicër.

Pjesëmarrës të tjerë: Mentor Tërshnjaku, Bahri Xhaferi – MPMS, Artan Murati- KDI, Ardian Halimi UKZ, Berita Abazi, UP, Liza Gashi dhe Fjolla Ukshinaj, Germin dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e komisionit, Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.1.2018**
- 3. Takim me znj. Barbara Gysi, anëtare e Komisionit për Politika Sociale të Parlamentit Konfederal të Zvicrës dhe z. Skënder Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.**
 - Temë diskutimi: Hapat për ratifikimin e marrëveshjes së pensioneve në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Zvicrës.
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

Kryetarja: Të nderuar të pranishëm, fillimisht më lejoni ta përshëndes anëtarin e Komisionit për politika Sociale të Parlamentit të Zvicrës, zonjën Barbara Gysi dhe ta falënderojë për pjesëmarrje në mbledhjen e komisionit, falënderoj edhe ministrin Reçica që i është përgjigjur ftesës sonë, përshëndes edhe ekspertin e çështjeve sociale, Ruzhdi Ibrahimini dhe përfaqësuesin e sindikatës “UNIA”, Osman Osmani.

Kjo temë që sot e kemi në rend të ditës është një temë me interes të veçantë, ku do të njoftohemi nga të pranishmit se deri ku kanë arritur proceset për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Ne kemi qenë të informuar nga ish- ministri, se në qershor të vitit 2017, është nënshkruar kjo marrëveshje, por pastaj nga diskutimi në seancën e fundit, nga ministri aktual u njoftuar se marrëveshja nuk është nënshkruar, por dy grupet teknike janë dakorduar që dy qeveritë në vazhdim do t'i nënshkruajnë marrëveshjet e pastaj do zhvillohen hapat tjerë drejt ratifikimit. Siç jeni të informuar, kjo është legjislatura e tretë radhazi që po diskutohet për këtë marrëveshje. Në prill bëhen 8 vite, që kur është ndërprerë kjo marrëveshje nga shteti i Zvicrës dhe qytetarët tanë që kanë punuar në Zvicër nuk po i gëzojnë këto të drejta. Po ashtu, jemi të njoftuar që edhe zonja Barbara Gysi dhe shumë deputetë të Parlamentit të Zvicrës kanë dhënë kontribut në arritjen e kësaj marrëveshjeje. Nuk dua të lëshohem në historikun e kësaj marrëveshjeje, por duam të njoftohemi më hollësisht se cilët janë hapat e ardhshëm që duhet ndërmarrë që kjo marrëveshje të nënshkruhet dhe të ratifikohet sa më shpejt. Ne jemi të interesuar të ndihmojmë këtë proces. Presim nga ministri të na njoftojë se deri ku ka arritur procesi i nënshkrimit të marrëveshjes për pensionet me Zvicrën.

Skënder Reçica: Ju faleminderit për ftesën. Për këtë çështje kam pasur edhe një pyetje parlamentare javën e kaluar. Nuk jam ndier mirë që marrëveshja ende nuk është nënshkruar. Personalisht, që nga marrja e postit, jam angazhuar në këtë çështje, mirëpo falënderoj edhe ambasadorin e Zvicrës në Prishtinë, i cili është angazhuar fuqishëm rreth arritjes së kësaj marrëveshjeje. Kemi paralajmërim se fundi i muajit mars do jetë momenti kur mund të nënshkruhet marrëveshja. Në vazhdim, do ju jap disa informacione rreth rrjedhës së kësaj marrëveshjeje.

Konfederata Helvetike (Zvicra), më datë 1 prill 2010, përmes një shkrese, ka informuar Qeverinë e Kosovës për ndërprerjen e Marrëveshjes për sigurime sociale, e nënshkruar në vitin 1962 me ish- Jugosllavinë.

- Në vitin 2013, Qeveria e Kosovës ka nisur negociatat për fillimin e një marrëveshjeje të re me Zvicrën.
- Nga viti 2013 deri në vitin 2015, grupet teknike (ekspertëve) të Kosovës dhe Zvicrës kanë zhvilluar negociatat teknike dhe kanë plotësuar formularë dhe pyetësorë që kanë ndihmuar në shkëmbimin e informacioneve në mes të palëve
- Para fillimit të hartimit të marrëveshjes së re bilaterale, pala zvicerane ka kërkuar që të arrihet një marrëveshje pilot, për të testuar pensionet e pleqërisë. Kjo marrëveshje është

arritur më 8 shkurt 2016, pasi që ka rezultuar e suksesshme, Qeveria e Zvicrës ka hapur negociatat për arritjen e marrëveshjes së përgjithshme sociale.

- Në janar 2017, Qeveria e Kosovës ka miratuar nismën për fillimin e negociatave, ku pas miratimit të kësaj nisme, janë realizuar tri raunde të negociatave në mes të palës kosovare dhe zvicerane.
- Në raundin e tretë të mbajtur në Bernë, është arritur të përafrohet drafti i marrëveshjes së përgjithshme për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Zvicrës dhe Marrëveshja administrative për zbatimin e marrëveshjes së përgjithshme. Më datë 1.6.2017, janë nënshkruar dy draftet e marrëveshjeve nga udhëheqësit e grupeve teknike dhe janë dakorduar që të përfundohen edhe disa çështje teknike si shkëmbimi i formularëve, si dhe dakordimin për përkthimin dhe përshtatjen e marrëveshjes së përgjithshme.

Nënshkrimi i marrëveshjes nga ministrat përkatës, sipas dakordimit zyrtar, pritet të bëhet në pjesën e parë të vitit 2018 (në fund të marsit). Përndryshe, MPMS ka njoftuar dhe përcjellë dy draftet, Marrëveshjen e përgjithshme për sigurime sociale në mes Kosovës dhe Zvicrës dhe draft-Marrëveshja administrative për zbatimin e marrëveshjes së përgjithshme të përafuar, të dt. 1.6.2017, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Kosovës.

Çka përmban draft-Marrëveshja e përgjithshme për sigurime sociale në mes Kosovës dhe Zvicrës?

Korniza kryesore, qytetarët e dy shteteve të realizojnë të drejtat e tyre siç janë: pensionet kontribut pagues (duke përfshirë dhe pensionet e kursimeve individuale-trusti pensional), pensionet familjare, pensionet invalidore të punës dhe pensioni bazik i moshës (pas ndryshimeve ligjore që janë paraqitur si kusht nga pala zvicerane, pensionet e testuara). Me këtë marrëveshje, qytetarëve kosovarë, të cilët kanë punuar një kohë të gjatë në Konfederatën e Zvicrës, do t'ju mundësohet që pas arritjes së moshës së pensionimit, të kenë të drejtë që këtë pension ta marrin në Kosovë. Qytetarëve kosovarë do t'ju mundësohet e drejta për t'i bashkuar periudhat e kontributeve (stazhit të punës), në mënyrë që të realizojnë pensionin, në rastet kur nuk është e mundur që të plotësojnë kushtet ligjore për pensionim, qoftë në Kosovë apo në Zvicër. Në anën tjetër, personat të cilët banojnë në Zvicër dhe plotësojnë kushtet për përfitime të ndonjërit pension, sipas legjislacionit të zbatueshëm, pala kosovare është e obliguar që ta eksportojë pagesën e pensionit nga Kosova në Zvicër.

Procedurat e brendshme

Eksportimi i pensionit, do të bëhet pas vendosjes së kërkesës nga organi kompetent i MPMS-së (Departamenti i Pensioneve) përmes sektorit financiar të MPMS-së, ndërsa ekzekutimi realizohet përmes Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore të Kosovës, në xhironlogarinë e palës sipas adresës së vendbanimit.

Barbara Gysi: Jam e kënaqur që jam këtu dhe ju faleminderit për ftesën. Për mua nuk është një vizitë zyrtare, por një vizitë mes miqsh. Unë kam shumë miq nga Kosova, që punojnë në Zvicër dhe është shumë e rëndësishme të gjejmë një zgjidhje dhe kjo marrëveshje të nënshkruhet sa më parë. Unë nuk mund të flas zyrtarisht për shtetin e Zvicrës, por informatat që unë i kam, janë të njëjta me ato që i tha ministri juaj. E di se arritja e marrëveshjes është stërzgatur, por vendimet politike janë në nivele ministrore, dhe sipas informatave, kjo mund të zgjasë edhe disa javë apo muaj. E rëndësishme është që ta kemi marrëveshjen e nënshkruar nga të dy qeveritë, e pastaj t'i ndërmarrim hapat e mëtutjeshëm për ratifikim. Në Zvicër, kemi dy dhoma të Parlamentit dhe ratifikimi i marrëveshjes mund të marrë pak kohë, ndoshta gjysmë viti. Ne duhet t'i bindim kolegët nga partitë e djathta, që ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është i domosdoshëm dhe se kjo është një gjë e mirë edhe për Zvicrën, sepse edhe nga Kosova do të eksportohen pensionet për në Zvicër, edhe pse nuk janë shumë të larta. Kemi edhe një grup të miqësisë të parlamentarëve të Zvicrës dhe të Kosovës, që do të jenë të gatshëm që të na ndihmojnë në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. E di që nuk është e drejtë që njerëzit, të cilët gjithë jetën e tyre kanë punuar në Zvicër dhe kanë paguar të gjitha tatimet dhe sigurimet, në fund të mos mund t'i marrin pensionet e tyre.

Edhe ministri ynë, z. Olabersy mendon se kjo që ka ndodhur nuk është e drejtë dhe është i interesuar që kjo marrëveshje të nënshkruhet sa më shpejt dhe të ecim përpara.

Ruzhdi Ibrahim: Ju falënderoj për ftesën dhe për gatishmërinë që kjo çështje të ecën tutje dhe njerëzit që janë dëmtuar me vite të tëra, të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre nga sigurimet shoqërore në Zvicër. Janë mbushur tetë muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes teknike në mes dy grupeve negociuse dhe opinionin nuk është i informuar se çfarë është ndërmarrë nga dy qeveritë për arritjen e marrëveshjes në fjalë. Kemi shumë njerëz, që tani tetë vite, nuk kanë arritur t'i realizojnë përfitimet në pensione të pleqërisë, pensione të invaliditetit, pensionet e veçorisë dhe pensionet e fëmijëve. Shumë nga këta përfitues, që kanë pasur të drejta, edhe kanë vdekur. Procedura e verifikimit të arritjes së marrëveshjes nga dy qeveritë është e domosdoshme. E domosdoshme për t'u cekur është pjesa e informimit e cila nga pala kosovare nuk është arritur sa duhet, njerëzit e prekur nuk e kanë informacionin e duhur sesi duhet të veprojnë gjatë kësaj periudhe. Përfitimet nuk mund t'i gëzojnë pa hyrë në fuqi marrëveshja. Pozitive në këtë aspekt është se historia e sigurimeve shoqërore në Zvicër nuk e njeh në Parlament një refuzim të një marrëveshjeje me ndonjë shtet, qoftë bilaterale, qoftë multilaterale. Është e rëndësishme që të bëhet konsolidimi i departamentit të pensioneve në Kosovë dhe që arritja e marrëveshjes të ketë një qëndrueshmëri. T'i bëhet me dije palës zvicerane që pala kosovare nuk ka asnjë kundërshtim përmbajtjesor në marrëveshjen ndërshtetërore mbi sigurimet shoqërore.

Skënder Reçica: Ratifikimi i marrëveshjes në parlamentet respektive bëhet vetëm pas nënshkrimit shtetëror të marrëveshjes dhe marrëveshja me Zvicrën ende nuk është nënshkruar. Është arritur përfundimi i negociatave, dhe sipas praktikës kur arrihet fundi i negociatave, arrihet marrëveshja në parim dhe vihen inicialet në fund të tekstit, nga grupet teknike. Tani jemi në pritje të ftesës, nga autoritetet zvicerane, për të nënshkruar marrëveshjen, dhe vetëm pasi të nënshkruhet marrëveshja, do të hapet mundësia e procesit të ratifikimit, nga parlamentet respektive. Ne si ministri, jemi të gatshëm dhe i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatim të marrëveshjes. Edhe me shtetin e Belgjikës jemi në negociata dhe jemi shumë afër arritjes së marrëveshjes. Pra, ne jemi zotuar se marrëveshjet e arritura do t'i zbatojmë me përpikëri. Procedurat e ratifikimit janë procedura parlamentare dhe ne duhet t'i pranojmë, edhe pse mund të ketë vonesa.

Osman Osmani: Ju falënderoj për pritjen dhe për gatishmërinë tuaj, ku që nga viti 2010, jemi takuar dhe kemi diskutuar që kjo çështje të ecën tutje. Jam sekretar nacional për migracion për anëtarët e Evropës Juglindore në sindikatën “UNIA” dhe kam për detyrë të përkujdesem edhe për mbi 10 mijë anëtarë, të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës. Përveç mbrojtjes dhe sigurisë në punë, janë edhe sigurimet shoqërore, për të cilat ne përkujdesemi që të zbatohen. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të informuar, ndoshta mjaftueshëm me këtë problematikë, por të prekurit nuk janë të informuar fare, nuk e dinë si të veprojnë në këtë situatë. Ministria ishte dashur t’i informojë për hapat që këta duhet t’i ndërmarrin. Ata, tani tetë vite janë zhvatur dhe keqpërdorur nga agjenci të ndryshme.

Flora Brovina: Përshëndes deputeten për pjesëmarrje në këtë takim. Me problematiken e shkëputjes së marrëveshjes jam njoftuar para tetë vitesh dhe që atëherë jam e informuar me punën që është bërë deri më tani. Me gjithë punën që është bërë gjatë kësaj kohe, prapë duhet thënë se ndaj punëtorëve të Kosovës, që kanë punuar aq gjatë në Zvicër dhe e kanë fituar të drejtën në pension, është bërë shkelje e të drejtave të tyre, dhe kjo është një shkelje e të drejtave të njeriut. Qeveria e Zvicrës ka bërë shumë për ne, sidomos kur i ka pranuar ata të punojnë në shtetin e tyre, por sot këta njerëz janë pjesë e shtetit zviceran, prandaj janë qytetarë që me nder e gëzojnë të drejtën në pension. Kjo shkelje e të drejtave të njeriut nuk i bën nder një shteti demokratik, si është Zvicra. Pyetja ime është: pse shtetet tjera të ish-Jugosllavisë i kanë gëzuar të drejtat sipas marrëveshjes së vjetër e Kosova nuk i ka gëzuar këto të drejta? Pyetja tjetër është: përveç të drejtës së pensioneve, qytetarët tanë a do t’i gëzojnë edhe të drejtat shëndetësore?

Faton Topalli: Përshëndes deputeten, znj. Barbara, Ruzhdin dhe Osmanin. Nëse dikush është angazhuar shumë për të drejtën e pensioneve të qytetarëve të Kosovës në Zvicër, atëherë është Partia Socialdemokrate e Zvicrës, e një angazhim maksimal e ka bërë edhe zonja Barbara Gysi. Në raportet e mira shqiptaro-zvicerane, çështja e pensioneve është njollë e zezë, për të cilën bartin përgjegjësi të dy vendet. Zvicra për shkak të partive të djathta, të cilat manipuluan duke thënë se qytetarët e Kosovës i keqpërdorën pensionet, ndërsa Qeveria e Kosovës, e cila pati një paralajmërim nga Qeveria e Zvicrës, për të diskutuar për pensionet, por nuk pati reagim fare. Pra, është një papërgjegjësi e cila megjithëse i takon të kaluarës, duhet të ceket. Qytetarët nga Kosova, nga të dy qeveritë u trajtuan keq. Më habit fakti se si vitin e kaluar ish- ministri Arban Abrashi deklaroi që me 1 qershor të vitit 2017, nënshkruhet marrëveshja në mes të dy vendeve, e që është një dezinformim, sepse marrëveshja nuk është nënshkruar, por është arritur vetëm marrëveshja në nivel teknik. Çështja tjetër që dua të shtoj, është mirë që marrëveshja të arrihet sa më shpejt, por kjo marrëveshje nuk është edhe një zgjidhje shumë e mirë që po bëhet. Marrëveshja fillon të zbatohet vetëm nga dita kur nënshkruhet dhe çka do të ndodhë me të drejtat e humbura të qytetarëve gjatë këtyre shtatë viteve. Nga ministri dëgjova se janë të gatshëm, kur të ftohen nga Zvicra, e pyes ministrin: përse nuk e merrni vetë iniciativën dhe të kërkonit që procesi të ecë përpara? Ju duhet ta merrni iniciativën dhe të veproni në mënyrë proaktive.

Time Kadrijaj: Përshëndes deputeten nga Parlamenti i Zvicrës dhe i them se me të vërtetë ke ardhur në mes miqsh. Ne, shtetin e Zvicrës e konsiderojmë vend mik të Kosovës. Falënderoj edhe ministrin për informatat e ofruara, sepse për një kohë të gjatë merremi me këtë çështje dhe jemi shumë të interesuar që kjo padrejtësi ndaj qytetarëve tanë, sa më parë të përfundojë dhe jemi të kënaqur që po i vije fundi. Përshëndes edhe përfaqësuesit e sindikatës “UNIA”, që janë prezentë dhe i falënderojmë për kontributin që kanë dhënë, drejt arritjes së kësaj marrëveshjeje dhe bashkëpunimin që kanë pasur me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Shpresoj që proceset do të ecën më shpejt dhe marrëveshja të nënshkruhet dhe të ratifikohet sa më shpejt. Pyetja ime ka të bëjë

gjithashtu me sigurimin shëndetësor, a do t'i gëzojnë pensionistët e Kosovës, që kanë punuar në Zvicër, sigurimet shëndetësore?

Enver Hoti: Falënderoj deputeten Barabara Gysi, Ruzhdiun dhe Osmanin për prezencën e tyre. Gjithashtu, falënderoj edhe ministrin Reçica për prezencën në komision. E dimë të gjithë kontributin e shtetit të Zvicrës, që nga vitet 60, kur ka mirëpritur, punësuar dhe strehuar shumë qytetarë të Republikës së Kosovës. I falënderoj në vazhdimësi për kontributin, në të gjitha etapat dhënë për shtetin e Kosovës. Sa i përket ndërprerjes së marrëveshjes së ish-Jugosllavisë, është bërë mirë që është ndërprerë, sepse ajo marrëveshje ka qenë e lidhur nga një shtet okupues, por nuk ka qenë mirë ai vakum që ka ndodhur, pas ndërprerjes së marrëveshjes deri më tani dhe që mijëra qytetarë të dëmtohen. Presim që marrëveshja të nënshkruhet sa më shpejt dhe mbështesim angazhimin e ministrit, në këtë drejtim. Përshëndesim edhe angazhimin e Qeverisë së Zvicrës dhe presim që sa më parë të nënshkruhet marrëveshja. Në përmbajtje të marrëveshjes u ngritën disa çështje, siç është çështja e sigurimeve shëndetësore dhe e kontributeve, të cilat, që nga viti 2010 nuk janë shpërndarë. Është mirë që këto çështje të parashikohen para arritjes së marrëveshjes finale. E lusim edhe deputeten zvicerane, zonjën Barbara, të angazhohet që kjo marrëveshje të arrihet sa më parë. Do ta ngremë çështjen edhe te grupet e miqësisë, që të kontribuojë në arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku: Edhe unë e përshëndes deputeten Barbara Gysi dhe mysafirët e tjerë. Të gjithë që jemi këtu, jemi të interesuar të kontribuojmë që sa më parë të arrihet kjo marrëveshje. Si deputetë, duam t'ju mbështesim në këtë proces, që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Kjo e drejtë është e mbrojtur edhe me konventa ndërkombëtare dhe kjo shkelje e të drejtave të njeriut nuk është dashur të ndodhë. Megjithatë, situata është si është dhe tani të gjithë jemi këtu që të japim kontributin tonë, duke falënderuar edhe Qeverinë e Zvicrës dhe atë të Kosovës, që kanë punuar me përkushtim që kjo marrëveshje të arrihet. Të shpresojmë që marrëveshja sa më shpejt të nënshkruhet dhe të ratifikohet.

Kryetarja: Siç thatë ministër, marrëveshja është nënshkruar nga grupet teknike dhe kishte qenë mirë që atë marrëveshje teknike që është arritur, ta kemi edhe ne dhe ta shohim se çka përmban, por do ishte mirë që marrëveshja të përfshinte edhe periudhën e humbur prej tetë vitesh, pra t'u kthehen qytetarëve mjetet e humbura. Çfarë keni bërë ju zotëri ministër në këtë çështje?

Skënder Reçica: Pas ratifikimit të marrëveshjes, ne si ministri jemi të përgatitur të informojmë qytetarët për mënyrat se si do të aplikojnë, për t'i gëzuar të drejtat që iu mundësohen me marrëveshje. Sa i përket të drejtave nga sigurimet shëndetësore, në marrëveshje thuhet që do të përfshihen të drejtat e sigurimeve sociale dhe shëndetësore sipas legjislacioneve respektive. Sa i përket iniciativës për nënshkrim të marrëveshjes, ju siguroj që kam marrë të gjithë hapat e duhur, që kjo marrëveshje të nënshkruhet sa më shpejt.

Faton Topalli: Propozoj që t'i drejtoheni me shkresë Qeverisë së Zvicrës dhe institucioneve përkatëse dhe t'ju thoni që, ne si Qeveri e Kosovës, i kemi kryer të gjitha obligimet e parapara dhe jemi të gatshëm të nënshkruajmë marrëveshjen. Nëse ka detyra që nuk i keni kryer ende, atëherë do të ketë ngecje. Pres nga ju që të jeni aktiv e mos të pritni, sepse Qeveria e Zvicrës i ka obligimet e veta.

Skënder Reçica: Sa i përket viteve të humbura, fatkeqësisht marrëveshja do të hyjë në fuqi prej datës së ratifikimit dhe qytetarët të drejtën për aplikim do ta kenë nga data e hyrjes në fuqi.

Ruzhdi Ibrahim: Është e rëndësishme që të trajtohen disa çështje përmbajtjesore, siç është çështja e periudhës tetë vjeçare, që të gjithë individët që kanë qenë të siguruar në Zvicër për këto vite nuk kanë të drejtë në përfitime. Shpesh po ndodh edhe një keqkuptim në informacion, ku po përzihet koncepti i sigurimeve shëndetësore dhe sigurimeve shoqërore. Marrëveshjet ndërshtetërore parashohin koordinimin e dy sistemeve të sigurimeve shoqërore. Për t'i koordinuar sistemet është e mundur nëse dy shtete kanë sistem të ngjashëm ose kur dy shtete i mbulojnë në tërësi rreziqet sociale. Por, marrëveshjet mund edhe të ndryshohen sipas legjislacionit që pëson ndryshime.

Kryetarja: Deputeten Barbara Gysi e kursyem nga pyetjet, pasi që kjo është deputete dhe me mundësitë e saj ka kontribuar që kjo marrëveshje të arrihet. Megjithatë, nëse keni ndonjë opinion për këto që u diskutuan, e mirëpresim kontributin tuaj.

Barbara Gysi: Pajtohem që ndërprerja e kësaj marrëveshjeje ka qenë shkelje e të drejtave të njeriut dhe për këtë unë dhe miqtë e mi deputetë jemi angazhuar shumë. Kemi pasur disa probleme në Kosovë, sidomos me regjistrat civilë, të cilët nuk kanë funksionuar si duhet, por edhe disa keqpërdorime dhe për këtë është ndërprerë marrëveshja. Sa i përket pyetjes për periudhën e kaluar, a mund të gëzohen të drejtat për këtë periudhë të humbur, do të angazhohem që edhe kjo çështje të negociohet, ndoshta nuk do të jetë e mundur, por sido që të jetë, e rëndësishme është që marrëveshja të arrihet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Osman Osmani: Sa i përket informimit të publikut, e pata fjalën që tani të bëhet informimi i të prekurve dhe mos të nguten t'i tërheqin mjete e tyre. Në Zvicër ndodh informimi i të prekurve dhe atë në të tri gjuhë.

Skënder Reçica: Edhe një herë po ua cek që ne jemi të gatshëm të bëjmë informimin e të prekurve, posa të arrihet marrëveshja.

Kryetarja: Pasi i diskutuam të gjitha çështjet me interes, ju falënderoi për pjesëmarrje. Gjithashtu, ju ftoj që për nder të mysafires nga Zvicra, komisioni të shtrojë një drekë pune.

Komisioni nxori këtë:

Vendim

Për nder të delegacionit nga Zvicra, të shtrohet drekë pune në restorant "Liburnia".

Kryetarja: Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU